



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 126, datë 21.06.2019

**PËR
MIRATIMIN E DHËNIES SË ÇMIMIT NGA AMF PËR PUNIMIN MË TË MIRË TË
PARAQITUR NË KONFERENCËN KOMBËTARE TË AMF-SË “EDUKIMI
FINANCIAR”**

Në bazë të nenit 14, pika 8, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar dhe në zbatim të vendimit të Bordit të AMF-së nr. 128, datë 31.08.2017 “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje (2017-2020)”, me propozim të Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së çmimit nga AMF në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, për punimin më të mirë me titull “*Aftësimi financiar dhe rëndësia e tij – Rasti i studentëve Shqiptarë*”, të prezantuar nga studentët e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Tiranës: Anisa Klefti, Arjana Shemilli, Brisilda Zeqaj dhe Kristjana Proko dhe të paraqitur në Konferencën Kombëtare “Edukimi Financiar”, të organizuar nga AMF në datën 24 maj 2019. Krahas vlerësimit simbolik, fituesit do të kenë mundësinë e një internshipi në AMF në dy departamentet kryesore të mbikëqyrjes për një periudhë 3-mujore.
2. Ngarkohet Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI